

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË

Zgjidhjet

P4

FLETË PROVIMI

Data 15.10.2016

Pjesa A. Pyetjet “rumbullakos përgjigjet”

Nga 1 pikë secila

1. Qëllimi dhe fushëveprimi i ligjit “Për Shoqëritë Tregtare është që të përcaktojë llojet e shoqërive tregtare përmes së cilave mund të zhvillohen veprimtaritë tregtare në Kosovë dhe çfarë llojit të tatimit duhet paguar.

E saktë

E pasaktë

2. Sipas Ligjit Për Shoqëritë Tregtare, një shoqëri tregtare mund të themelohet në Kosovë si ndërmarrje individuale, shoqëri kolektive, shoqëri komandite, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose shoqëri aksionare

E saktë

E pasaktë

3. Një person ose shoqëri tregtare e cila ka për qëllim ta shfrytëzojë një emër tregtar brenda një afati vijues prej njëqindetëdhjetë (180) ditësh mundet, në qoftë se ky emër tregtar nuk është rezervuar ose regjistruar më parë, ta rezervojë shfrytëzimin ekskluziv të këtij emri tregtar, duke ia paraqitur regjistrimit një kërkesë mbi rezervimin e emrit tregtar. Kërkesa duhet të përmbajë emrin dhe adresën e parashtruesit të kërkesës dhe emrin tregtar të cilin dëshiron ta rezervojë.

E saktë

E pasaktë

4. Kurdo që një shoqëri tregtare e thekson kapitalin e saj në një dokument formal ose korrespondencë, ai theksim po ashtu duhet të përfshijë edhe një indikacion të qartë dhe të saktë të shumës së kapitalit të shoqërisë tregtare i cili është paguar.

E saktë

E pasaktë

5. Sipas Ligjit “Për Shoqëri Tregtare” Çdo shoqëri e regjistruar tregtare duhet të caktojë një person të autorizuar për të dorëzuar në Zyrën e Regjistrimit raportin vjetor.

E saktë

E pasaktë

6. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 “Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim”, Pasqyrat financiare të shoqëritë tregtare të mesme do të auditohen vetëm nga auditorët që janë të licencuar për të kryer auditime nga autoritetet

kompetente siç janë definuar në këtë ligj.

E saktë

E pasaktë

7. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 “Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim” Shoqëritë tregtare, subjekte të këtij ligji, duhet të verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e asetëve, të detyrimeve dhe të kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

E saktë

E pasaktë

8. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 “Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim” Shoqëritë tregtare të mëdha dhe të mesme sipas nenit 4, paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. të këtij ligji, mund ti mbajnë regjistrat kontabël edhe në Gjuhën angleze, pa pasur nevojë për përkthim.

E saktë

E pasaktë

9. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 “Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim”, dokumentet kontabël në bazë të të cilave janë kryer regjistrimet ruhen së paku në afat prej dhjetë (10) vitesh;

E saktë

E pasaktë

10. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 “Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim”, Personi që është kualifikuar si kontabilist i certifikuar nga një shoqatë e licencuar profesionale kontabiliteti dhe auditimi dhe vazhdon të jetë anëtar me status të rregullt pranë një shoqate profesionale të kontabilitetit dhe auditimit ka të drejtë të përdor titullin “kontabilist i certifikuar”.

E saktë

E pasaktë

11. Bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo person i cili i nënshtrohet ndonjë lloj tatimi të administruar nga ATK do të regjistrohet në mënyrë

vullnetare në ATK dhe do të marrë një numër fiskal para se të angazhohet në ndonjë veprimtari ekonomike.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo tatimpagues pa marrë parasysh qarkullimin vjetor, përveç mbajtjes së librave dhe regjistrimeve të parapara me ligj, kërkohet të bëjë dhe mbajë regjistrimin e mallrave në stoqe në fund të vitit kalendarik. Regjistrimet e parapara sipas këtij paragrafi duhet të jenë të gatshme më apo para 20 janarit të vitit vijues.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në qoftë se data e fundit e deklarimit e përshkruar në legjislacion për ndonjë lloje të tatimit nuk është ditë pune në Kosovë, data e deklarimit do të jetë dita e parë e punës pas kësaj date.

E saktë

E pasaktë

14. Bazuar në Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në qoftë se regjistrimet e një personi të vetë-punësuar kanë humbur apo janë shkatërruar ose ekzistojnë rrethana tjera që bëjnë të pamundur përcaktimin e shumës së kontributeve për pension të detyrueshme, Drejtori i Përgjithshëm mund të bëjë një vlerësim të kontributeve për pension të barabartë me nivelin e detyrimit të kontributeve për periudhën e mëparshme mujore ose tremujore.

E saktë

E pasaktë

15. -Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo shumë e tatimit e paguar mbi shumën e detyrimit tatimor, me kërkesën e tatimpaguesit do të kreditohet ndaj detyrimit aktual të tatimpaguesit për çdo detyrim tjetër tatimor dhe kontribute pensionale.

E saktë

E pasaktë

16. Sipas Ligjin nr .05/L-028 Për Tatimin ne te Ardhurat Personale, edhe pagat e personave me nevoja të veçanta, siç parashihet me ligjet përkatëse për këto kategori janë te ardhura te tatueshme.

E saktë

E pasaktë

17. Sipas Ligjin Nr. 05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, rezident është një person fizik i cili ka një vendqëndrim kryesor në Kosovë ose fizikisht është i pranishëm në Kosovë mbi njëqind e tetëdhjetë e tre (183) ditë në çdo periudhë kohore dymbëdhjetë (12) mujoreje.

E saktë

E pasaktë

18. Sipas ligjit nr.05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, Pensionet e paguara në përputhje me legjislacionin përkatës mbi Pensionet në Kosovë janë të ardhura të pa tatueshme.

E saktë

E pasaktë

19. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, kompanitë, për sigurimin ose ri sigurimin e jetës, pronës ose rreziqeve të tjera, të licencuara nga BQK-ja, i nënshtrohen normës tatimore prej shtatë për qind (7%) të primeve bruto të grumbulluara gjatë periudhës tatimore.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, nëse shumat e paguara, apo kredituar e vitit përkatës janë më të mëdha se shuma e përgjithshme e tatimit e caktuar në përputhje me këtë ligj, tatimpaguesi ka të drejtën e rimbursimit të shumës së tepërt të tatimeve të paguara apo me kërkesën e tatimpaguesit ka të drejtën e bartjes si paradhënie për vitin vijues.

E saktë

E pasaktë

21. Sipas ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, nuk do të lejohet zbritje për çdo shpenzim të rrjedhë bazuar në një obligim të mbajtjes në burim, përveç nëse shpenzimet e tilla të jenë paguar në ose para 31 marsit të periudhës pasuese tatimore.

E saktë

E pasaktë

22. Sipas ligjit të TVSh-se, nëse personi brenda vitit kalendarik tejkalon qarkullimin prej pesëdhjetëmijë euro (50.000€) kërkohet që të regjistrohet për TVSH.

E saktë

E pasaktë

23. Sipas Ligjit të TVSH-se, Çdo person, përveç nëse nuk është rregulluar ndryshe me këtë ligj, është i obliguar që të regjistrohet për TVSH nga momenti i kalimit të limitit të qarkullimit për tu regjistruar sipas këtij ligji dhe duhet të njoftojë ATK-në brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike prej momentit kur ka lindur obligimi për regjistrim

E saktë

E pasaktë

24. Shfrytëzimi i mallrave nga personi i tatueshëm që janë pjesë e mjeteve të biznesit të tij, për shfrytëzim privat ose për personelin e tij apo deponimi me to i lirë nga ngarkimi ose në përgjithësi shfrytëzimi i tyre për nevoja të tjera nga ato të biznesit, duhet të trajtohet si furnizim i mallrave me ngarkim të TVSh-se, ku TVSH-ja është plotësisht ose pjesërisht e zbritshëm në këto mallra apo në pjesët e tyre përbërëse.

E saktë

E pasaktë

25. Sipas ligjit të TVSh-së, personi, të cilit i transferohen mjetet, duhet të trajtohet si pasardhës i transferuesit në lidhje me mjetet e transferuara dhe nuk duhet të ngarkohet me TVSH në atë transferim, me kusht që pasardhësi i transferuesit është person i tatueshëm i cili është i regjistruar ose është i obliguar të regjistrohet për TVSH. Transferuesi dhe ai që pranon transferimin, duhet të njoftojnë ATK-në për qëllimin e tyre për zbatimin e këtij neni së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para se të ndodhë transferimi.

E saktë

E pasaktë

26. Sipas ligjit të TVSh-se, furnizimet me librat shkollore dhe publikimet serike aplikohet norma e reduktuar (8%).

E saktë

E pasaktë

27. Furnizimi i shërbimeve nga mediat elektronike të radios dhe televizionit është furnizim i liruar me te drejtën e zbritjes së TVSH-se se zbritshëm

E saktë

E pasaktë

28. Sipas ligjit të TVSH dhënia dhe negocimi i kredisë dhe menaxhimi i kredisë nga personat që e ofrojnë atë është furnizim i liruar nga TVSH-ja;

E saktë

E pasaktë

29. Sipas ligjit të TVSH-së, ari, metalet tjera të çmueshme, bankënotat dhe monedhat metalike të importuara nga Banka Qendrore e Kosovës janë të obliguara të paguajnë TVSH me rastin e importit.

E saktë

E pasaktë

30. Personi i tatueshëm mund të zbres TVSH-në e zbritshëm edhe para periudhës tatimore në të cilën ai i ka pranuar faturat për mallrat apo shërbimet e furnizuara për të ose në të cilën ai ka pranuar deklaratën e doganës për mallrat e importuara.

E saktë

E pasaktë

31. Sipas ligjit të TVSH-se mallrat në valixhet personale të udhëtarit të cilat janë importuar për qëllime jo komerciale dhe të cilat janë të liruara nga pagesa e detyrimeve doganore në pajtueshmëri me legjislacionin doganor në fuqi janë të liruara dhe nga TVSH-ja.

E saktë

E pasaktë

32. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosove, mosha e pensionimit për femra është mosha 62 vjeçare ndërsa për meshkuj është mosha gjashtëdhjetë e pesëvjeçare (65).

E saktë

E pasaktë

33. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosove, për të gjitha kategoritë e personave të vetëpunësuar, minimumi i tremujorit të kontributeve do të jetë tridhjetë përqind (30%) të pagesës Minimale.

E saktë

E pasaktë

34. Kontributet pensional nga të punësuarit e huaj me qëndrim të përkohshëm në Kosovë, nuk janë të lejuara.

E saktë

E pasaktë

35. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosove, nëse Fondi konstaton se një punëdhënës, punonjës apo person i vetëpunësuar ka dhënë kontribute të tepërta, Fondi mund t'i kthejë kontributet e tilla të tepërta në pajtim me rregullat e Administratës Tatimore të Kosovës

E saktë

E pasaktë

36. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, njëri nga disa llojet e pensioneve vjetore është edhe lloji: pensioni vjetor i të mbijetuarit është i pagueshëm gjatë jetës së pjesëmarrësit dhe pastaj gjatë jetës së bashkëshortit të saj ose bashkëshortes së tij për pjesën e mbetur të jetës së saj apo të tij.

E saktë

E pasaktë

37. Sipas Ligjit të Punës, asnjë punëdhënës nuk mund të lidhë kontratë pune me ndonjë person nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç.

E saktë

E pasaktë

38. Sipas ligjit të Punës, punëdhënësi në sektorin privat, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës.

E saktë

E pasaktë

39. Sipas Ligji të Punës, Puna Provuese mund të zgjasë, më së shumti gjashtë (6) muaj në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit..

E saktë

E pasaktë

40. Sipas Ligjit të Punës, punësuari i cili për herë të parë themelon marrëdhënie pune ose i cili nuk ka ndërprerje më tepër se pesë (5) ditë pune, fiton të drejtën për shfrytëzimin e pushimit vjetor pas gjashtë (6) muajsh të punës së pandërprerë, në proporcion me muajt e punuar.

E saktë

E pasaktë

Pjesa B. Pyetjet problemore

Problemi 1

15 pikë

Në fillim të vitit 2013 ndërmarrja PROJEKTI nënshkruan një kontratë për ndërtimin e një rrokaqielli me Investitor Prishtina. Ndërtesa do të ketë 18 kate. Periudha e ndërtimit do të zgjasë përafërsisht 3 vite. Gjithsej të ardhurat sipas kontratës janë 18 milion euro. Shpenzimet e vlerësuara janë 16 milion euro. Në fund të vitit 2014, vlerësimi i shpenzimeve totale deri në përfundim të projektit pritet të jetë 16.5 milion euro shpenzime.

	2013	2014	2015
Shpenzimet e ndodhura deri në datë	4,960,000	9,500,500	16,500,000
Gjithsej shpenzimet e vlerësuara	16,000,000	16,500,000	16,500,000

Kërkohet:

Përcaktoni fazat e realizimit dhe fitimin e tatueshëm gjegjësisht tatimin në fitim sipas Ligjit TAK për vitit 2013;2014 dhe 2015 për Punëkryerësin e PROJEKTTIT.

Zgjidhje:

Shpenzimet dhe të ardhurat e kontratës njihen duke përdorur metodën e përqindjes së realizimit. Faza e realizimit përcaktohet duke krahasuar shpenzimet e ndodhura me gjithsej shpenzimet e pritura.

	2013	2014	2015
Kostot e vlerësuara	16,000,000	16,500,000	16,500,000
Kostot e ndodhura	4,960,000	9,570,000	16,500,000
Faza e realizimit (kostot e kontratës si % e kostove të vlerësuara)	31 %	58 %	100 %

Viti 2013

Të ardhurat (18,000,000 x 0.31)	5,580,000
Kostot	(4,960,000)
Fitimi	620,000
Tatimi (620,000 x 10%)	62,000

Viti 2014

	Te ndodhura 31.12.2014	Te njohura vitin e kaluar	Te njohura vitin Aktual
Të ardhurat (18,000,000 x 0.58)	10,440,000	5,580,000	4,860,000
Kostot	(9,570,000)	(4,960,000)	(4,610,000)
Fitimi	870,000	620,000	250,000
Tatimi (250,000 x 10%)	87,000	62,000	25,000

Viti 2015

	Te ndodhura 31.12.2015	Te njohura vitin e kaluar	Te njohura vitin Aktual
Të ardhurat (18,000,000 x 1)	18,000,000	10,440,000	7,560,000
Kostot	(16,500,000)	(9,570,000)	(6,930,000)
Fitimi	1,500,000	870,000	630,000
Tatimi (630,000 x 10%)	150,000	87,000	63,000

Problemi 2

5 pikë

Kompania EKI SH,P.K për vitin që përfundon me 31.12.2015 kishte një fitim para donacionit 85,000€. Shpenzimet e donacionit për këtë vit ishin 20,000 EUR. Pas një rishikimi u konstatua se shpenzimet e përfaqësimit ishin përfshi si shpenzim mbi limitin e lejuar sipas ligjit, vlera e mbi limitit ishte 2,000€.

Kërkohet:

Llogaritni obligimin tatimor pas rregullimeve të nevojshme bazuar në Ligjin mbi të ardhurat e korporatave për kompaninë EKI Sh.p.k. me 31.12.2015.

Zgjidhje

Fitimi para donacionit i pa korigjuar	85,000
<u>Shpenzimet e përfaqësimit mbi limit</u>	<u>2,000</u>
Fitimi para Donacionit	87,000
<u>1* Donacioni</u>	<u>(8,700)</u>
Fitimi para tatimit	78,300
<u>Tatimi 10%</u>	<u>7,830</u>

1* Donacioni lejohet deri në 10% të fitimit para donacionit

Problemi 3

10 pikë

Kompania Nojtra SH,P.K për vitin që përfundon me 31.12.2015 kishte një qarkullim EUR 1,000,000. Shpenzimet e përgjithshme ishin EUR800,000.

Informacion shtesë: Te gjitha këto shpenzime si me poshtë janë përfshirë në shpenzimet e përgjithshme me përjashtim të pikës 3.

1. Provizioni i përgjithshëm për llogarit e arkëtushme sipas menaxhmentit për këtë viti ishte 2% e shumës së tërësishme të llogarive të arkëtushme (llogarit e arkëtushme me 31.12.2015 kanë vlerën bruto 100,000 EUR).
2. Shpenzimet e zhvlerësimit të aseteve ishin me të ulëta sipas kontabilitetit financiar në raport me llogaritjen e kontabilitetit të tatimeve për j 6,000 EUR .
3. Është blerë një aset i grupit të tretë në vlerë prej 45,000 EUR, nuk është aplikuar zbritja e posaçme për pasurin e re.
4. Shpenzimet e përfaqësimit kanë shumën prej 12,500 EUR.
5. Shpenzimet e donacionit për këtë vit janë 35,000 Eur , por në këtë shumë është përfshirë edhe një sponsorizim i veçantë i njohur sipas ligjit në vlerë prej 10,000 EUR.

Kërkohet:

Llogaritni obligimin tatimor pas rregullimeve të nevojshme bazuar në Ligjin mbi të ardhurat e korporatave për kompaninë NOJTRA Sh.p.k. me 31.12.2015

Zgjidhje

Te ardhurat	1,000,000
SHP	(800,000)
Fitimi Kontabël	200,000

Rregullimet:

Provizioni(1*)	2,000
Zhvlerësimi (2*)	(6,000)
Zbritja e posaçme(3*)	(4,500)
Shpenz. përfaqësimit (4*)	2,500
Donacioni	35,000
Fitimi par Donacionit	229,000
Donacioni(5*)	(32,900)
Fitimi para tatimit	196,100
Tatimi (10%)	19,610

1* Provizionimi i llogarive te arktushme pa u shndërruar ne borxh te keq sipas ligjit te TAK nuk është shpenzimi i zbritshëm për qëllime tatimore.

2* Për qëllime tatimore shpenzimet e zhvlerësimit njifen ne vlerën e paraparë sipas përqindjes se lejuar ne ligjin e TAK.

3* Zbritje e posaçme për asetin e ri lejohet 10% e vlerës kushtuese vetëm ne vitin e blerjes
Vlera e asetit $45,000 \times 10\% = 4,500$ shpenzim për zbritje e posaçme

4* Shpenzimet e përfaqësimit

Qarkullimi $1,000,000 \times 1\% = 10,000$ (limiti i shpenzimeve te lejuara)

Shpenzimet e përfaqësimit $12,500 - 10,000 = 2,500$ (shpenzime te pa lejuara)

5* Donacioni pranohet ne tërësi si shpenzim pasi qe është nen limitin e lejuar nga Ligji TAK (10% e fitimit para donacionit + 10% kur kemi spozorizime te veçanta sipas ligjit)

Sqarim shtesë pika 5 : 229,000 fitimi para tatimit (10% donacioni i lejuar 22,900), donacioni i aplikuar 25,000 (35,000 - 10,000), diferenca 2,100€ (25,000 - 22,900)

Sponsorizim i veçantë është 100% i pranuar pasi $229,000 \times 0.1 = 22,900$; $22,900 - 10,000$ e lejuar me tepër.

Donacioni i rregullt	22,900
<u>Donacioni si sponsorizim i veçantë</u>	<u>10,000</u>
Total	32,900

Problemi 4

10 pikë

“LANA” SH.P.K regjistroi blerje gjatë Korrik/2016 në shumën 20,000EUR me normën standarde; blerje në shumën 10,000EUR me normën e reduktuar; shitjet vendore në këtë muaj 30,000EUR me normën standarde dhe 5,000EUR me normën e reduktuar (Vlerat e paraqitura janë pa përfshirë TVSH-në).

Ne muajin Korrik 2016 “LANA” SH.P.K ka lëshuar një Note Debiti për një blerës për një shitje në muajin Shkurt 2016, vlera e TVSH-se në këtë note debiti është Eur 330(me normë standarde);

“LANA” SH.P.K po ashtu në këtë muaj kishte një kreditim të bartur nga muaji paraprak në vlerë prej 2,200 EUR.

Kërkohet:

A ka detyrim TVSH-së për të paguar në këtë muaj “LANA” SH.P.K”, nëse po sa është obligimi ? Plotëso deklaratën tatimore.

Zgjidhje

Libri i shitjeve

Shitjet me norme të reduktuar	$5,000 \times 8\% = 400$
Shitjet me norme standarde	$30,000 \times 18\% = 5,400$
<u>Note Debiti e lëshuar</u>	<u>$1,834 \times 18\% = 330$</u>
TOTAL TVSH e llogaritur	6,130

Libri i blerjeve

Blerjet me normën e reduktuar	$10,000 \times 8\% = 800$
<u>Blerjet me normën standarde</u>	<u>$20,000 \times 18\% = 3,600$</u>
TOTAL TVSH e zbritshëm	4,400

TVSH e pagueshme = TVSH e llogaritur - TVSH e zbritshëm - Kreditimi i bartur
TVSH e pagueshme = 6,130 - 4,400 - 2,200 = -470 (mbetet në kreditim)

Problemi 5

15 pikë

Në fillim të vitit 2013 Investitori PRISHTINA nënshkruan kontratën me punekryerësin PROJEKTI për ndërtimin e një rrokaqielli . Ndërtesa do të ketë 18 kate me gjithsej 36,000 m². Periudha e ndërtimit do të zgjasë përafërsisht 3 vite. Gjithsej të ardhurat sipas vlerësimit janë 25 milion 200 mijë euro. Shpenzimet e vlerësuara janë 16 milion e 500 mijë euro.

Ne vitin e parë Kompania i nënshkruan dy kontrata shitje

Kontrata 1 (Lokal Afarist). 200 m² x 700= 140,000 Eur, avanca e pagesës EUR30,000 (me rastin e nënshkrimit të kontratës), pagesat tjera EUR20,000 për vit duke filluar nga viti i dytë. (Vlerat janë pa TVSH)

Kontrata 2 (Banesa). 10,000 m² x 700= 7,000,000Eur, avanca e pagesës 30% (me rastin e nënshkrimit të kontratës), pagesat tjera 1,000,000 për vit duke filluar nga viti i dytë. (Vlerat janë pa TVSH)

Ne vitin e parë Kompania pranoje një faturë nga kontraktori PROJEKTI

Vlera e fature ishte 5,580,000 euro pa ngarkese të TVSH por me përshkrim se duhet aplikuar ngarkesa e kundërt.

Koeficienti i ndërtesës është 30% shitje me TVSH dhe 70% shitje pa TVSH

Kërkohet:

Plotëso nga një deklaratë vjetore për TVSH për Investitorin PRISHTINA për vitin 2013 duke aplikuar ngarkesën e kundër për faturat e lëshuara nga Kontraktori PROJEKTI ndërsa shitjet klasifikohen sipas përqindjes së koeficientit.

Zgjidhje

2013

Nr.	Emërtimi	Shitjet		TVSH e llogaritur
[9]	Shitjet e liruara pa te drejte kreditimi	2,100,000		
[12]	Shitjet e tatueshme me normën 18%	30,000	[13]	5,400
[28]	Blerjet qe i nënshtrohen ngarkesës se kundërt me normën 18%	5,580,000	[29]	1,004,400

Nr.	Emërtimi	Blerjet		TVSH e zbritshëm
[33]*	Blerjet, Importet me TVSH jo të zbritshëm	3,906,000		
[65]*	E drejta e kreditimit te TVSH-se ne lidhje me ngarkesën e kundërt me norme 18%	1,674,000	[66]	301,320

TVSH e pagueshme = TVSH e llogaritur - TVSH e zbritshëm

TVSH e pagueshme = 1,009,800 - 301,320

= 708,480 EUR (për pagesë)

33* 5,580,000 x 70%=3,906,000 (blerje pa TVSH të zbritshëm)

65* 5,580,000 x 30%= 1,674,000 (blerje me TVSH të zbritshëm)

Problemi 6

5 pikë

Shega Sh.P.K. në muajin Korrik 2016 ka pranuar aktin final të kontrollit për periudhën e viti 2015 për Tatimi ne te ardhurat e korporatave (TAK). Ne aktin final ATK ka konstatuar tatim shtesë prej 2,000 EUR.

Kompania ka deklaruar dhe dorëzuar deklaratën përfundimtare me 15 Prill 2016. Me deklaratë përfundimtare është paguar pjesa e mbetur e tatimit në TAK prej 1,000 EUR. Tatimi i përgjithshme sipas Shega SH.P.K për këtë periudhe ishte në shumën prej 30,000 Euro.

Kërkohe:

Sa janë gjobat dhe interesi për tatimin shtese (sipas aktvendimit të ATK-së) që kompania duhet paguar duke u bazuar në kalkulimet që parasheh Ligji mbi Procedurat dhe Administratën Tatimore ?

Zgjidhje

1*.Gjoba për nen deklarim tatimor	$2,000 \times 15\%$	=	300
2* Gjoba për mos deklarim në kohë	$2,000 \times 5\%$	=	100
3* Gjobe për mos pagese ne kohe	$2,000 \times 3\%$	=	60
4* Interesi	$2,000 \times 2.8\%$	=	56
TOTALI			516

1* Neni 52 pika 1.1 i ligjit për procedurat dhe administratën tatimore vendoset ndëshkimi pesëmbëdhjetë për qind (15%) të diferencës mes shumës korrekte të tatimeve që duhet të deklarohet dhe shumës që në të vërtetë është deklaruar aty ku ndodh që nen deklarimi i tillë ose mbi-deklarimi është deri në 10% apo me pak.

2*Neni 51 pika 1 i ligjit Proc. ATK për mos deklarim te tatimit ne kohe ndëshkim 5% për muaj max 5 muaj. Ne rastin konkret kemi te bëjmë me 1 muaj vonese.

3*Neni 51 pika 2 i ligjit Proc. ATK për mos pagese tatimit ne kohe ndëshkim 1% për muaj max 12 muaj. Ne rastin konkret kemi te bëjmë me 3 muaj.

4* Neni 28 pika 1 i ligjit Proc. ATK-se, deri në ditën e pagesës së tatimit llogaritet interes 0.70% ne muaj. Ne rastin konkret ne kemi të bëjmë me 4 muaj mos pagesë të tatimit.